

Klubi i Librit "Mësojmë nga e kaluara"

Nga dosja te rrëfimi: Historia e familjes Martini

nga Dr. Brunilda Çërraga

Ky material është përgatitur në kuadër të Klubit të Librit "Mësojmë nga e kaluara", pjesë e platformës "Mësojmë nga e kaluara – Burime Arsimore të Hapura 1944–1991", zhvilluar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, Zyrën Vendore Arsimore dhe Bibliotekën: "Marin Barleti" Shkodër. Libri: "Nëpër shtigjet e ferrit" ndërthur rrëfimin autobiografik të Viktor Martinut me dokumente origjinale të arkivit të ish-Sigurimit të Shtetit, duke ofruar një lexim paralel të kujtesës dhe dokumentit historik.

Ruajtja e kujtesës historike nuk kufizohet vetëm në administrimin dhe vënien në dispozicion të dokumenteve arkivore. Ajo kërkon që këto dokumente të dalin nga arkivi dhe të bëhen pjesë e dialogut me shoqërinë, veçanërisht me edukimi qytetar me fokus brezat e rinj me qëllim edukimin historik.

Mbi këtë mision është ndërtuar platforma "Mësojmë nga e kaluara – Burime Arsimore të Hapura 1944-1991, një nismë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, e zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit(2021) sot Ministria e Arsimit.

Platforma synon të ofrojë një qasje bashkëkohore në edukimin historik, duke vënë në dispozicion dokumente arkivore, dëshmi, materiale didaktike dhe veprimtari edukative që ndihmojnë në njohjen e periudhës së diktaturës komuniste në Shqipëri e cila nuk është e përfshirë në tekstet mësimore dhe përmes kësaj platforme dhe materialeve të saj, historia bëhet e prekshme përmes burimeve autentike dhe fateve njerëzore.


Një nga aktivitetet kryesore të platformës është Klubi i Librit "Mësojmë nga e kaluara", një hapësirë ku letërsia memuaristike dhe dokumenti arkivor vendosen në dialog.

Qëllimi i këtij libri nuk është vetëm prezantimi i një libri, por ndërtimi i një procesi reflektimi, ku kujtesa personale ballafaqohet me dokumentacionin e krijuar nga ish-Sigurimi i Shtetit.

Në çdo takim përzgjidhet një vepër autobiografike ose memuaristike e lidhur me periudhën e diktaturës. Rrëfimi i autorit shërben si pikënisje, ndërsa dokumentet arkivore bëhen burimi që ndihmon në rindërtimin e historisë dhe në kuptimin e mekanizmave të përndjekjes politike.

Në këtë takim u përzgjodh libri "Nëpër shtigjet e ferrit" i Viktor Martinut.

Historia e familjes Martini nuk fillon me arrestimin e Viktor Martinit. Ajo nis më herët dhe gjurmët e saj ruhen në dokumentacionin arkivor të Zef Martinit. Duke ndjekur këto dokumente, bëhet e mundur të rindërtohet kronologjia e një përndjekjeje që, nga fundi i viteve '40, do të shtrihej mbi disa anëtarë të së njëjtës familje.



Dokumentet e dosjes së Zef Martinit përbëjnë pikën e parë të kontaktit me historinë arkivore të kësaj familjeje. Ato dëshmojnë fillimin e përndjekjes politike dhe mënyrën se si një individ, përmes një dosjeje, shndërrohej në objekt të kontrollit të vazhdueshëm të aparatit shtetëror.

Në këto dokumente pasqyrohet arrestimi i Zef Martinit më 2 gusht 1949, me akuzën për pjesëmarrje në një grup kundër pushtetit. Ish-oficer i Mbretërisë Shqiptare, ai u dënua me pesëmbëdhjetë vjet burg dhe humbi jetën në Burgun e Burrelit, pa u bërë i mundur identifikimi i vendit të varrimit të tij.

Megjithatë, historia e familjes Martini nuk përfundon me këtë dënim. Përkundrazi, ai shënon fillimin e një kalvari që do të përfshinte edhe katër djemtë e tij. Dokumentet arkivore dëshmojnë se përndjekja nuk mbeti e kufizuar te një individ, por u shtri mbi të gjithë familjen, duke e kthyer biografinë në një instrument ndëshkimi.

Siç shkruan Viktor Martini në librin e tij:

"Fjala arrest ishte mortja e fatkeqësia jonë që na ndoqi gjithë jetën."

Kjo fjali përmbledh në mënyrë domethënëse pasojat e një sistemi ku dënimi politik nuk përfundonte me individin, por ndiqte familjen brez pas brezi.


Nëse dosja e Zef Martinit shënon fillimin e përndjekjes së familjes, dokumentet që lidhen me Viktor Martinin tregojnë se si kjo përndjekje u trashëgua te brezi i dytë.

Në arkivin e ish-Sigurimit të Shtetit ruhet dokumentacioni që pasqyron arrestimin, hetimin, gjykimin dhe dënimin e tij, duke ndërtuar kronologjinë e një historie që kishte nisur vite më parë.

Viktor Martini lindi në Korçë më 12 prill 1940. Në moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare ai u arrestua dhe u përball me një proces hetimor e gjyqësor që do të ndryshonte përgjithmonë jetën e tij. Në dokumentet arkivore ai paraqitet si objekt i ndjekjes penale; në librin *Nëpër shtigjet e ferrit*, ai paraqitet si një djalë i ri që përjeton pasojat e një sistemi ku biografia familjare kishte marrë peshën e një dënimi të paracaktuar.

Dokumentet tregojnë procedurën institucionale të ndjekur ndaj tij. Libri, ndërkohë, sjell përjetimin njerëzor të së njëjtës ngjarje. Pikërisht në këtë pikë ndërthuren dy burime të ndryshme: dokumenti shpjegon mënyrën se si funksiononte aparati shtetëror, ndërsa rrëfimi zbulon pasojat që ai aparat la mbi jetën e një të riu dhe familjes së tij.

Nga dokumentacioni arkivor rezulton se familja Martini është një nga rastet ku përndjekja politike nuk mbeti e lidhur vetëm me një person. Gjatë katër dekadave të diktaturës, pesë burrat e familjes vuajtën gjithsej 104 vjet burg politik, një tregues i qartë i mënyrës se si regjimi e shtrinte përgjegjësinë politike mbi të gjithë familjen.



Ndër dokumentet më domethënëse të dosjes së Viktor Martinut është apeli, një dokument që dëshmon përpjekjen për të kërkuar rishikimin e vendimit të dhënë ndaj tij.

Lexuar sot, ky dokument nuk ka vetëm vlerë juridike. Ai dëshmon përpjekjen e një individi për t'u dëgjuar nga një sistem ku mundësitë për mbrojtje ishin pothuajse të papërfillshme. Në të pasqyrohet jo vetëm procedura e kohës, por edhe besimi se e vërteta mund të gjente ende një rrugë për t'u shprehur.

Apeli është një nga ato dokumente që, krahasuar me kujtimet e autorit, fiton një kuptim më të gjerë. Ai nuk mbetet thjesht një akt procedural, por bëhet pjesë e historisë personale të një të riu që kërkonte drejtësi në rrethana ku drejtësia ishte e kushtëzuar nga sistemi politik dhe kjo është letra e shkruar nga Viktori në formë apeli gjë që është e dokumentuar në dosjen formulare të tij.

Ky dokument është ndër më prekësit e kësaj historie pasi ndryshe nga procesverbalet, raportet apo vendimet gjyqësore, ku flet zëri i institucionit në atë letër flet vetë njeriu. është letra me shkrim dore e Viktor Martinut, aty ku nuk dëgjohet zëri i njeriut.

Në këtë letër gjendet një rrëfim i drejtpërdrejtë për përvojën e burgut, për vuajtjet dhe pasojat që përndjekja politike la mbi jetën e tij dhe të familjes së tij. Ajo përfaqëson një dëshmi të rrallë, ku dokumenti arkivor nuk flet për viktimën, por i jep fjalën vetë viktimës.

Një nga fragmentet më domethënëse të këtij rrëfimi është pohimi:

"Fjala arrest ishte mortja e fatkeqësia jonë që na ndoqi gjithë jetën."

Në këtë fjali përmbledhet drama e një familjeje, por edhe përvoja e shumë familjeve shqiptare që u përballën me të njëjtin fat gjatë regjimit komunist. Pikërisht ky është momenti kur dokumenti arkivor dhe kujtesa personale bashkohen, duke krijuar një dëshmi historike më të plotë se secili




burim më vete.

Ndër dokumentet që tërheqin vëmendjen në dosjen e Viktor Martinit është edhe skica e arratisjes. Në pamje të parë ajo duket si një dokument teknik, i hartuar për të pasqyruar një ngjarje konkrete. Megjithatë, e lexuar në raport me kujtimet e autorit, ajo fiton një kuptim më të gjerë.

Skica dokumenton mënyrën se si organet e Sigurimit të Shtetit rindërtonin ngjarjet, duke i shoqëruar ato me përshkrime, itinerare dhe elementë grafikë.

Ajo nuk përfaqëson vetëm një provë dokumentare, por edhe mënyrën se si aparati shtetëror ndërtonte dosjet hetimore dhe argumentonte akuzat ndaj personave që ndiqte.

Vendosur përballë rrëfimit autobiografik të Viktor Martinit, ky dokument i jep lexuesit mundësinë të shohë të njëjtën ngjarje nga dy këndvështrime të ndryshme: nga njëra anë kujtesën e atij që e përjetoi dhe nga ana tjetër mënyrën se si ajo u pasqyrua në dokumentacionin zyrtar.



Ky dokument i përket periudhës së ndryshimeve politike në Shqipëri.

Dokumentet e kësaj dosjeje dëshmojnë një realitet të ri, kur regjimi komunist po shkonte drejt fundit, ndërsa shumë prej atyre që kishin vuajtur përndjekjen politike u bënë pjesë e lëvizjeve që shoqëruan rrëzimin e simboleve të diktaturës dhe në këtë rast ngjarjet në Shkodër.

Në këtë kontekst dokumentohen edhe ngjarjet e lidhura me Viktor dhe Rudolf Martinin, pjesëmarrës në rrëzimin e bustit të Stalinit në Shkodër, një akt simbolik që shënoi refuzimin e trashëgimisë së diktaturës.

Edhe në këtë periudhë, dokumentet arkivore dëshmojnë vazhdimësinë e ndjekjes dhe të dhunës së ushtruar nga strukturat e Sigurimit të Shtetit ndaj qytetarëve që kërkonin ndryshim.

Këto dokumente mbyllin një cikël historik që kishte nisur më shumë se katër dekada më parë me arrestimin e Zef Martinit. Për familjen Martini, fundi i regjimit nuk fshiu pasojat e përndjekjes, por hapi rrugën drejt rikthimit të kujtesës dhe dokumentimit të së vërtetës.

Historia e familjes Martini është historia e një familjeje shqiptare që përjetoj për dekada pasojat e përndjekjes politike. Ajo dëshmon se diktatura nuk godiste vetëm individin, por edhe familjen, duke e shtrirë dënimin përtej brezit të parë.

Në këtë Klub Libri, rrëfimi autobiografik i Viktor Martinit dhe dokumentet arkivore të ruajtura nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit vendosen në dialog për të rindërtuar një histori të dokumentuar mbi baza të dyfishta: burimin arkivor dhe kujtesën personale.

Ky është edhe qëllimi i Klubit të Librit "**Mësojmë nga e kaluara**": të krijojë një hapësirë ku historia lexohet përmes njerëzve që e kanë jetuar dhe dokumenteve që e dëshmojnë atë.

Në këtë mënyrë, libri fiton mbështetje dokumentare, ndërsa dokumenti arkivor merr dimension njerëzor.

Përmes këtij dialogu ndërmjet kujtesës dhe arkivit, historia nuk mbetet vetëm pjesë e së shkuarës. Ajo shndërrohet në një mjet për edukimin historik, reflektimin qytetar dhe ruajtjen e kujtesës kolektive, duke i ndihmuar brezat e rinj të kuptojnë se pas çdo dosjeje arkivore fshihet historia e një njeriu dhe e një familjeje.